

**VENDIM**  
**Nr.680, datë 22.10.2004**

**PËR SHPALLJEN E SISTEMIT LIGATINOR VJOSË-NARTË PEIZAZH UJOR/TOKËSOR I MBROJTUR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 dhe 23 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpalljen e sistemit ligatinor Vjosë-Nartë peizazh ujqor/tokësor të mbrojtur.
2. Ky sistem ligatinor kufizohet dhe përfshin një sipërfaqe si më poshtë vijon:
  - a) Peizazhi ujqor/tokësor i mbrojtur, i paraqitur në hartën që i bashkëlidhet vendimit dhe është pjesë përbërëse e tij, kufizohet:

Në veri: nga ekstremi verior i grykëderdhjes së lumit të Vjosës dhe nga vetë lumi Vjosë deri në Mifol;

Në perëndim: nga deti Adriatik;

Në lindje: nga kreshta, që bashkon majat e Mishikartës, të Cecait, Cipllakut, Kishës, Mutrevës dhe nga Babica e Vogël;

Në jug: nga Vlora (pusi i Mezinit), fusha e kriqores, pylli i sodës, parku industrial.

- b) Peizazhi ujqor/tokësor i mbrojtur ka një sipërfaqe të përgjithshme orej 19 738 ha, të përbërë nga:

|                                                                                |          |
|--------------------------------------------------------------------------------|----------|
| Sipërfaqe ligatinore (sipërfaqe ujqore, zona të lagëta, ranore/toka marginale) | 7225 ha; |
| Sipërfaqe pyjqore                                                              | 1167 ha; |
| Sipërfaqe bujqësore                                                            | 7798 ha; |
| Sipërfaqe urbane                                                               | 277 ha;  |
| Sipërfaqe ujqore                                                               | 2985 ha; |
| Aeropotiti                                                                     | 286 ha.  |

3. Peizazhi ujqor/tokësor i mbrojtur ka këto ndarje zonale:

a) Zona qendrore e ruajtjes së biodiversitetit (shënuar në hartë me shkronjën “A”) përfshin rezervatin e Pishë-Poros, lagunat e Kallenges, pyllin e Poros, Shamadurën Limopuan, pyllin dhe ishujt e Zvërnecit. Brenda saj ka dy nënndarje (A1 dhe A2), që përcaktojnë mënyrën e administrimit. Zonat e nënndarjes A1 ruhen dhe mbrohen në mënyrë strikte. Zonat e nënndarjes A2 ruhen, por edhe përdoren për qëllime ripërtëritje natyrore.

b) Zonat e përdorimit tradicional (shënuar në hartë me shkronjën “B”), që nuk cenojnë mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, përfshijnë tokat bujqësore (të Dellinjës, Zhukës dhe të aeropotit), kriqoret dhe pjesën perëndimore të lagunës së Nartës. Brenda saj ka dy nënndarje (B1 dhe B2), për mënyrën e administrimit. Në nënndarjen B1 zhvillohen veprimtari ekonomike tradicionale, si peshkimi, akuakultura, gjuetia, turizmi, bujqësia dhe blegtoria. Në nënndarjen B2 zhvillohet veprimtaria ekonomike tradicionale e nxjerrjes së kriqës.

c) Zona e zhvillimit të qëndrueshëm (shënuar në hartë me shkronjën “C”) përmbledh fushën e Bilbilit, të Akernisë, Novoselës, Skroftinës, Panajasë dhe Nartës, si dhe kodrat e fshatrave Trevllazër, Llakatund, Kërkovë e Bestrovë. Në brendësi të kësaj zone mund të zhvillohen veprimtari ekonomike, si bujqësi, gjueti, blegtoria, tregti, pemëtari, ndërtime etj., që nuk cenojnë natyrën dhe biodiversitetin.

ç) Zona e zhvillimit turistik (shënuar në hartë me shkronjën “D”).

4. Ngarkohet administrata e rezervës natyrore të menaxhuar të Pishë-Poros, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe të Kullotave, të kryejë administrimin e peizazhit ujqor/tokësor të mbrojtur të sistemit ligatinor Vjosë-Nartë.

5. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe e Kullotave të hartojnë rregulloren e administrimit dhe planin e menaxhimit të peizazhit ujqor/tokësor të mbrojtur të sistemit ligatinor Vjosë-Nartë.

6. Ngarkohen Ministri i Mjedisit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe e Kullotave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Fatos Nano**

